



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.K4/I70-2 Prot.
Nr. Dok. 202503470/2

Tiranë _19/_09_/2025

Lënda: Sugjerohet marrja e masave për përmirësimin e kushteve dhe respektimin e të drejtave të migrantëve të pa rregullt nga ana e strukturave të Policisë Kufitare dhe Migracionit, në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm.

Drejtuar: Drejtorit të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

TIRANË

I nderuar Z. Drejtor,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, ju bëjmë me dije se Avokati i Popullit, në përmbushje të detyrave kushtetuese, ka ushtruar inspektime dhe monitorime të vazhdueshme në zonat kufitare me Greqinë dhe në brendësi të vendit.

Qëllimi i inspektimit ishte ndjekja e zbatimit të ligjshmërisë në menaxhimin e flukseve migratore të parregullta dhe respektimi i të drejtave dhe trajtimi i migrantëve të huaj, sipas dispozitave ligjore të parashikuara në legjislacionin tonë, si dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, për këtë qëllim.

Gjatë periudhës monitoruese për vitin 2025, janë konstatuar, përveç arritjeve, edhe disa mangësi në veprimtarinë e përditshme të Policisë Kufitare dhe Migracionit në terren, të cilat sugjerojmë të përmirësohen.

Hyrjet migratore në Shqipëri vijnë me ritme të konsiderueshme. Në përgjithësi, emigrantët e konsiderojnë vendin tonë si territor tranzit drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe, në fund, drejt shteteve të Bashkimit Evropian. Përveç përdorimit të mjeteve të transportit publik, gjatë këtij viti është konstatuar një rritje e dukshme e përpjekjeve për kalimin e territorit shqiptar nëpërmjet kontrabandës. Kjo tregon si shtim të kërkesës nga ana e emigrantëve, ashtu edhe intensifikim të ofertës kriminale për tranzitimin e tyre. Në këtë kuadër, është evidentuar gjithashtu përdorimi i dokumenteve

të falsifikuara. Megjithatë, një pjesë e këtyre individëve paraqesin interes edhe për të kërkuar azil.

Në legjislacionin shqiptar, të drejtat e të huajve janë të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, neni 16, pika 5 përcakton: *“Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë, vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.”* Ky parim kushtetues është materializuar më tej në ligjin nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt”.

Gjithashtu, Republika e Shqipërisë është palë në Konventën e Gjenevës “Për statusin e refugjatëve” të vitit 1951 dhe në Protokollin e Nju Jorkut të vitit 1967, si dhe ka miratuar marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), të sanksionuar me ligjin nr. 7833, datë 22.6.1994. Këtë të drejtë e gëzojnë refugjatët të cilët përkufizohen në Nenin 1 të Konventës, ku thuhet shprehimisht se: *“Një person që, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet dhe nuk ka mundësi, ose për shkak të një frike të tillë, nuk ka dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi; ose kur ai, duke mos pasur shtetësi dhe ndodhet jashtë vendit të mëparshëm të banimit të zakonshëm të tij, si pasojë e këtyre ngjarjeve, nuk ka mundësi ose nuk ka dëshirë të kthehet atje, për arsye të kësaj frike.”*

Në këtë kuadër, për të garantuar respektimin e këtyre standardeve dhe për të arritur një menaxhim më human e në përputhje me sigurinë kombëtare, MKPT pranë Avokatit të Popullit. Nga vizita e kryer në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Shkodër, ka konstatuar disa problematika që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme, të referuara si më poshtë vijon:

- Të huajt e parregullt intervistohen në një zyrë të specialistëve të migracionit, ku mungojnë krejtësisht afishet apo fletëpalosjet informuese në gjuhë të ndryshme që ata mund të kuptojnë. Përkthimi realizohet vetëm në gjuhën arabe, nëpërmjet një hoxhe të kontaktuar me telefon, i cili nuk është asnjëherë i pranishëm gjatë procesit të intervistimit.
- Në Shkodër mungojnë ambientet e posaçme për akomodimin e të huajve. Në raste urgjente, Drejtorisë i vjen në ndihmë “Fshati i Paqes”, i menaxhuar nga Kisha Katolike, i cili i strehon për disa orë, kryesisht gjatë natës, kur patrullat i sjellin të huajt në polici.
- Megjithëse Policia Kufitare e Shkodrës trajton një numër të konsiderueshëm të huajsh krahasuar me drejtori të tjera në kufi me Greqinë, nga kjo strukturë nuk janë evidentuar raste as për përzgjedhje për azil dhe as për dërgim në Qendrën e Mbyllur të Kareçit. Vetëm gjatë muajit gusht janë trajtuar gjithsej 82 të huaj, nga të cilët 45 janë kapur në dalje drejt Malit të Zi dhe 37 janë ripranuar nga ky shtet.

Në thelb, të gjitha shkeljet e konstatuara lidhen me mungesën e komunikimit të plotë me të huajt e parregullt, për shkak të mungesës së përkthyesve. Përdorimi i gjuhës angleze, e parashikuar në ligj si alternativë, nuk ka mundur të garantojë zbatimin korrekt të

dispozitave ligjore të cituara më sipër. Gjithashtu, nga kontaktet e marra në Departament, rezulton se nuk ka projekt buxhetor për përmirësimin e kushteve të akomodimit të të huajve në Qendrën e Mbyllur Kareç.

Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, strukturat shtetërore përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, si dhe ato për Azilin, gjatë zbatimit të kontrolleve kufitare, intervistimit dhe përzgjedhjes së migrantëve, duhet të konsiderojnë dhe rishqyrtojnë kërkesat e migrantëve të parregullt për azil, në harmonizim të plotë me ligjet, politikat dhe praktikatat ndërkombëtare të parashikuara në Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndaluar me efekt të menjëhershëm prapësimet, të cilat i ndalojnë migrantët që të largohen nga vendi i tyre i origjinës apo që të arrijnë në BE, me qëllim që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar dhe gëzuar azil.

Në përfundim, Avokati i Popullit në kuadër të misionit të tij kushtetues dhe ligjor, do të vijojë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të shtetasve të huaj dhe kryesisht të migrantëve të parregullt që hyjnë në territorin e vendit tonë, duke siguruar standarde më të larta në respektimin e këtyre të drejtave, sikurse janë parashikuar në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; germa “b”, të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;

SUGJEROJMË:

1. Marrjen e masave urgjente, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe duke shfrytëzuar burimet e Policisë Kufitare dhe Migracionit, për të evidentuar dhe angazhuar përkthyes në gjuhët që përdoren më gjerësisht nga emigrantët e parregullt që hyjnë në Shqipëri. Kjo është e domosdoshme për të garantuar zbatimin korrekt të kërkesave ligjore.
2. Departamenti i Kufirit dhe Migracionit të ndërmarrë masa urgjente për të udhëzuar në mënyrë të detajuar gjithë personelin e angazhuar në procesin e intervistimit dhe përzgjedhjes, përfshirë edhe atë të Qendrës së Mbyllur Kareç, mbi të drejtën për azil dhe procedurat përkatëse.
3. Duke qenë se ndryshimet e shpeshta të personelit të Policisë Kufitare ndikojnë në cilësinë e punës, të organizohen trajnime të vazhdueshme me qëllim njohjen e plotë të ligjeve që garantojnë të drejtat e emigrantëve të parregullt dhe të azilkërkuarve. Këto trajnime duhet të rrisin kapacitetet profesionale të stafit që kryen intervistimet dhe përzgjedhjen.
4. Të organizohen trajnime të posaçme për oficerët e policisë gjyqësore të Kufirit dhe Migracionit në bazë, si dhe për përgjegjësit e turneve në PKK, lidhur me zbatimin korrekt të ligjit “Për të huajt”, ligjit “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe të

Kodit të Procedurës Penale, sidomos në rastet kur të huajt ndiqen penalisht ose kapen me dokumente të falsifikuara.

5. Në bashkëpunim me IOM dhe UNHCR, të furnizohen PKK-të, stacionet e kufirit të gjelbër dhe Qendra e Mbyllur Kareç me fletëpalosje të përgatitura në disa gjuhë të kuptueshme për emigrantët, ku të pasqyrohen qartë të drejtat e tyre, si dhe të jepen adresat e plota për ankimime dhe kontakte me avokatë (të zgjedhur prej tyre ose sipas mundësive që kanë).
6. Departamenti i Kufirit dhe Migracionit të hartojë një udhëzim të posaçëm që të parashikojë qartë të drejtën e emigrantëve për t'u ankuar administrativisht brenda hierarkisë së Departamentit.
7. Të ushtrohen kontrole të rregullta mbi punonjësit e policisë në terren për të verifikuar zbatimin në praktikë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre sugjerimeve, lutemi të na informoni.

Duke ju uruar suksese në detyrën tuaj dhe duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e mëtejshëm,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI
dv**